



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 17 datë 16/02/1998

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Tiranës, i mbledhur me dt.16.02.1998, pasi mori në shqyrtim relacionet e grupit të punës të ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë me Nr.8, dt.12.01.1998, në zbatim të V.K.M. Nr.585, dt.11.12.1997, “Për evidentimin e familjeve që kanë humbur banesat nga rënia e firmave piramidale”, mbështetur në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”,

V E N D O S I

1. Të miratojë listën e qytetarëve të cilët kanë shitur banesat e tyre në qytetin e Tiranës dhe kanë humbur paratë e shitjes së tyre në firmat piramidale, sipas tabelave bashkangjitur këtij Vendimi.
2. Ti kërkojë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për familjet që nuk kanë mundur të plotësojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin përkatës pranë Bashkisë Tiranë, për efektet kohore të shkurtra që janë përcaktuar në V.K.M. Nr.585, dt.11.12.1997, për të bërë të mundur evidentimin e tyre të shtyhet afati i përcaktuar në këtë Vendim.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndërtim Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI